



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK  
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_, 2020

**Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, 07.2020**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, me Vendimin Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, 07.2020, APP ka vendosur të përjashtojë për **15 (pesëmbëdhjetë) muaj** operatorin ekonomik "Dule" Shpk, me NIPT J82401502P, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për keqinformim dhe dorëzim të dokumentave, që përmbajnë të dhëna të rreme.

**I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa):**

"Dule" Shpk, me NIPT J82401502P, me adresë: Rr. "Maliq Muco", Ndërtesa Nr. 5, Hyrja 4, Ap.3, Tiranë.

**II. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:**

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Dule" Shpk ka nisur në bazë të shkresës së dërguar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale e Fier Sh.a, i cili ka kërkuar përjashtimin e subjektit "Dule" Shpk nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për keqinformuar dhe dorëzim të dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi në mbështetje të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

**III. Gjetjet:**

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 13/3/a të LPP.

**IV. Masat:**

Me Vendimin Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, 07.2020, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Dule" Shpk për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) muaj nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, pasi është vërtetuar fakti se, ky operator ekonomik ka keqinformuar për qëllime kualifikimi në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale e Fier Sh.a, sa i takon paraqitjes së deklaratës sipas shtojcës Nr. 8.